

ARDIAN MUHAJ

RRETH PRANISË SË DETARËVE SHQIPTARË NË ANGLI GJATË MESJETËS

Të dhënat e paraqitura në këtë punim janë pjesë e një studimi më të gjerë rreth pranisë së shqiptarëve në Angli gjatë Mesjetës. Qëllimi ynë është që në vija të përgjithshme të sjellim dëshmi mbi praninë e shqiptarëve në Angli gjatë Mesjetës, dhe në të njëjtën kohë të japim një kontribut modest për identifikimin e saktë të mjaft personave, të cilët në punimet e studiuesve të huaj, janë paraqitur si italianë, dalmatë, skiavonë, grekë, madje edhe si spanjollë, portugezë, francezë, apo si të pidentifikueshëm.

Dëshmitë për praninë dhe rolin e shqiptarëve në vendet e Europës Veriore, veçanërisht në Vendet e Ulëta dhe Angli në shek. XIV e XV, edhe pse të pakta në numër janë të rëndësishme sepse hedhin dritë mbi aspekte pak të njohura ose të panjohura të historisë sonë në këtë periudhë. Rruga e mbërritjes së këtyre shqiptarëve në Europën Veriore, ka qenë ajo detare, në bordin e anijeve tregtare italiane, kryesisht venedikase. Itinerari i lundrimit që niste në Venecia, kishte si destinacion Flandrën, ose më saktë qendrën më të rëndësishme tregtare të saj, Bryzhin (Brugge-Bruges) deri në fundin e shek. XIV, dhe pastaj duke filluar prej kësaj kohe e deri në mbylljen zyrtare të kësaj linje tregtare lundrimi në fillimin e shekullit XVI, kishte gjithnjë destinacion të dyfishtë: Anglinë (Londër, Southampton e Sandwich)¹ dhe Flandrën (Sluis dhe Bryzhe). Ndërmjet këtyre dy pikave itinerari përfshinte edhe pushime të kohëzgjatjes së ndryshme në portet kryesore të Sicilisë, Jugut të Spanjës, dhe Portugalisë. Itinerari i miratuar nga Senati, natyrisht ndryshonte në varësi të kushteve të lundrimit, kur anijeve u duhej të gjenin strehim të përkohshëm nga stuhitë².

¹ *Port Books of Southampton for the Reign of Edward IV*, edited by D. B. Quinn and A. A. Ruddock, vëll. II, 1477-1481. Southampton: Cox & Sharland, 1938, (më tej *PBS*, II, 1477-1481), f. xviii. Vetëm duke filluar nga viti 1434 galerat e Londrës filluan të përdornin Southamptonin si vendtakimi me galerat që shkonin në Sluis, mbasi deri atëherë kishin si vendtakimi portin e Sandwich-it.

² Kur niseshin drejt Flandrës, bënin ndalesa në Siçili, Napoli, Majorka, Malaga, Kadis, Lisbonë dhe Ferrol, ndërsa në kthim ndalonin në Kadis, Almeria, Malaga, Majorka dhe Siçili. *PBS*, II, 1477-1481, f. xx. Mbi galetë e Flandrës në

Duhet theksuar se linja e lundrimit të Flandrës, ishte linja më e vështirë e lundrimit në historinë dhe në gjeografinë e lundrimeve mesjetare. Për këtë arsye edhe anijet që përdorshin për këtë linjë ishin më të mirat dhe më të sigurtat e arsenalit venedikas. Udhëtimi i plotë vajtje-ardhje shkonte nga 10 deri në 18 muaj, prej të cilëve 3-4 muaj ishin lundrim, ndërsa koha tjetër ishte qëndrim nëpër portet ku tregtoreshin mallrat e Sinjorisë³.

Në përgjithësi shqiptarët, ashtu si edhe dalmatët, boshnjakët e grekët, ishin të punësuar si rremëtarë apo si marinarë, dhe jo si tregtarë, edhe pse aftësisht e shfrytëzojnë pozicionin e tyre si rremëtarë për të marrë me vete një numër të kufizuar mallrash të cilat mund t'i tregtonin, duke marrë në njëfarë mënyre rolin e tregtarëve të vegjël.

Vendosja e linjave të rregullta të lundrimit mes Mesdheut dhe Detit të Veriut, përmes Ngushticës së Gjibraltarit dëshmohe vetëm duke filluar nga fillimi i shekullit XIV. Deri në atë kohë lidhjet tregtare mes Mesdheut dhe Europës Veriore mbaheshin nëpërmjet rrugëve tokësore, të cilat për vetë kushtet gjeografike, kalonin nëpër Francë. Panairët tregtare të Shampanjës, në verilindje të Francës, ishin vendtakimi i preferuar i

përgjithësi shih edhe: Randown Brown, *Calendar of State Papers and Manuscripts relating to English Affairs existing in the Archives and Collections of Venice, and in Other Libraries of Northern Italy*, (më tej CSP, Venice), vëll. I, (1202-1509). London, 1864, f. 35 e në vazhdim; Adolf Schaube, "Die Anfänge der venezianischen Galeerenfahrten nach der Nordsee", *Historische Zeitschrift*, 101, München: 1908, f. 28-89; Roberto Cessi, "Le relazioni commerciali tra Venezia e le Fiandre nel sec. XIV", *Nuovo archivio veneto*, 27, 1914, f. 5-116, edhe pse autori e trajton këtë temë vetëm deri në vitin 1376; Alwyn A. Ruddock, *Italian Merchants and Shipping in Southampton, 1270-1600*, Southampton: University College, 1951; Frederic C. Lane, *Le navi di Venezia fra i secoli XIII e XVI*, Torino: 1983; E. B. Fryde, "Italian Maritime Trade with Medieval England (c. 1270-c. 1530)", *Recueils de la Société Jean Bodin* nr. 32, 1974, f. 291-337; Alberto Sacerdoti, "Note sulle galere da mercato veneziane nel XV secolo", *Bollettino dell' Istituto di storia della società e dello stato Veneziano* IV, 1962, f. 80-105; Bernard Doumerc, "Il dominio del mare", në *Storia di Venezia: Dalle origini alla caduta della Serenissima*, a cura di Alberto Tenenti e Ugo Tucci, vëll. 4, Romë: Istituto della Enciclopedia Italiana, 1996, f. 113-180.

³ Mbas vitit 1474 udhëtimi shkoi duke u zgjatur. Madje mund të ndodhte që edhe dy flota të njëpasnjëshme të takoheshin rrugës, siç ndodhi me flotën e vitit 1479 që në kthim hyn në Southampton më 12 shkurt 1481, dhe në të njëjtën ditë hyn në port flota e vitit 1480 që i drejtohej Flandrës. *PBS*, II, 1477-1481, f. xxix.

tregtarëve europianë deri në fillimin e shek. XIV⁴. Duke filluar prej dekadës së fundit të shekullit të XIII anijet gjenoveze e katalanenë fillim e më pas edhe ato venedikase, filluan të bëjnë rrugën e Ngushticës së Gjibraltarit⁵. Venecianët e ndërmorën këtë rrugë më vonë se sa gjenovezët e katalanët por e vazhduan më gjatë. Periudha kur kjo rrugë detare njohu edhe kulmin e lulëzimit të saj ishte nga fundi i shek. XIV e deri në mesin e shek. XV⁶.

Të dhënat e para rreth pranisë së detarëve shqiptarë në Angli i gjejmë që në fundin e shek. XIV. Në këtë kohë venedikasit nisin të frekuentojnë edhe Anglinë, ngaqë deri atëherë zakonisht shkonin drejt Flandrës, pa u ndalur në portet angleze. Rekrutimi i shqiptarëve në galerat e linjave tregtare venedikase merr hov pikërisht në këtë kohë, madje edhe më përpara se Venediku të merrte në zotërim qytetet e pellgut të Shkodrës e Lezhës. Kjo ka të bëjë me faktin se në fundin e shek. XIV, Sinjoria mbas fitores së luftës me Gjenovën (1378-1381) del si forca më e fuqishme detare në Mesdhe⁷.

Nga ana tjetër në këtë kohë, Venecia u godit nga një numër epidemish të murtajës, që riktheheshin periodikisht që prej vitit 1348. Vetëm epidemia e vitit 1348 vlerësohet të ketë vrarë rreth një të tretën apo ndoshta edhe gjysmën e popullsisë së Venedikut. Një tjetër shpërthim

⁴ Henri Pirenne, *A History of Europe from the Invasions to the XVI Century*, London: Allen & Unwin, 1967, f. 351-353; Robert-Henri Bautier, "Le marchand lombard en France aux XIII^e et XIV^e siècles", në *Actes des congrès de la Société des historiens médiévistes de l'enseignement supérieur public*. 19^e Congrès, Reims, 1988, f. 66-68, 71-73, 79.

⁵ Archibald R. Lewis, "Northern European Sea Power and the Straits of Gibraltar, 1031-1350 A. D.", në *Order and Innovation in the Middle Ages. Essays in Honor of Joseph R. Strayer*, Edited by William C. Jordan, Bruce McNab, Teofilo F. Ruiz, Princeton, New Jersey: Princeton University Press, 1976, f. 139-164; Federigo Melis, "Gli italiani e l'apertura delle vie Atlantiche", në *idem, Mercaderes italiani en España. Siglo XIV-XVI. (Investigaciones sobre su correspondencia e su contabilidad)*. Sevilla: Universidad de Sevilla, 1976, f. 170 e në vazhdim.

⁶ William Cunningham, *The Growth of English Industry and Commerce during the Early and Middle Ages*, 5th edition, Cambridge University Press, 1915, f. 426.

⁷ Pompeo Molmenti, *Venice its Individual Growth from the Earliest Beginnings to the Fall of the Republic*, Translated by Horatio F. Brown, part I, The Middle Ages, vol. I, Chicago: A. C. McClurg, 1906, f. 129.

i murtajës në vitin 1382 mendohet të ketë shkaktuar 19 mijë viktima⁸. Si pasojë Venediku kishte një mungesë të madhe krahësh pune për flotën detare. Sikur të mos mjaftonte murtaja, në këtë kohë Venediku humbi edhe zonën prej ku tradicionalisht rekrutoheshin detarët mbas marrjes së zotërimeve dalmate nga Mbretëria Hungareze⁹.

Që prej fundit të shek. XIV e deri në fundin e shek. XV, shqiptarët vazhdojnë të jenë të pranishëm në anijet venedikase në rrugën tregtare që lidhte Mesdheun me Europën Veriore. Natyrisht që pesha specifike që zinte tregtia e këtyre shqiptarëve në tërësinë e marrëdhënieve tregtare mes Mesdheut dhe Anglisë nuk ishte e madhe, por përfshirja e shqiptarëve në këtë tregti është padyshim një tregues me rëndësi për shkallën e zhvillimit ekonomik e social të shqiptarëve në këtë shekull.

Dy janë portet kryesore angleze në të cilat qëndronin dhe bënë tregti anijet shtetërore venedikase: Londra dhe Southamptoni. Dëshmitë më të hershme dalin në Londër, për vetë faktin se Southamptoni fillon të vizitohet nga galerat venedikase rreth katër dekada më vonë se sa Londra, aty nga fundi i viteve '30 të shek. XV.

Një nga dëshmitë më të hershme dhe njëkohësisht më domethënëse të pranisë së shqiptarëve në Londër i përket vitit 1396. Këtë e dëshmojnë të dhënat që dalin nga një proces gjyqësor kundër Pal Aleksit apo Pal Lezhjanit dhe gjashtë bashkëpunëtorëve të tij në dhjetor të vitit 1396¹⁰. Katër galetë venedikase që kryenin linjën e Flandrës për atë vit kishin si pronarë Pasqual Zane, Francesco Leone, Giovanni Morosini dhe Bernardo Giustinian. Në kanalën e La Manshit, siç ishte bërë zakon ky

⁸ Simbas Frederic C. Lane, *Venice. A Maritime Republic*, Baltimore: The John Hopkins University Press, 1973, f. 19. Numri i viktimave të epidemisë së vitit 1347-1348 duhet të ketë mbërritur në tre të pestat e numrit total të popullsisë së Venecias prej 100-120 mijë banorësh. Pra, në prag të epidemisë së vitit 1382, Venecia kishte vetëm 60-65 mijë banorë.

⁹ F. Lane, *Venice: A Maritime Republic ...*, f. 197; Carlo M. Cipolla, *Before the Industrial Revolution. European Society and Economy, 1000-1700*, third edition. London: Routledge, 1993, f. 203, mendon se epidemitë që riktheheshin herë mbas here që prej vitit 1348, e shtuan jo vetëm nevojën për krahë pune, por edhe vlerën reale të punës së krahut.

¹⁰ ASV, Avogadori de Comun, Raspe, 5, c. 60 (57) t-61 (58), 20 dhjetor 1396; Giuseppe Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, (më tej: AAV), I/3, Munchen: Rudolf Trofenik, nr. 673; Stefano Piasentini, "La setta di Londra: Un ammutinamento di ciurme veneziane del 1396", *Studi Storici*, Fondazione Istituto Gramsci, 37/ 2, 1996, f. 513.

grup u nda në dy pjesë: dy të parat, Zana e Leona u drejtuan drejt Londrës, ndërsa Morosina e Giustinana me në krye kapitenin e përgjithshëm vazhduan drejt Flandrës, me destinacion Sluis, që ishte edhe porti i jashtëm i Bryzhit dhe Antverpit. Si kapiten i përgjithshëm i flotës Senati caktoi Piero da Vidor, ndërsa Pasquale Zane, u emërua zëvendëskapiten.

Udhëtimi vajtje-ardhje i flotës së galerave për atë vit zgjati 9 muaj, duke u nisur më 20 mars nga Venecia dhe duke mbërritur në Londër nga fundi i qershorit¹¹. Pali bashkë me shumë shqiptarë të tjerë që merrnin pjesë në këtë udhëtim, në galerat Zana dhe Leona, udhëtuan drejt Londrës dhe këtu nisën problemet e kapitenëve të këtyre galerave me anëtarët e ekuipazhit të tyre¹². Procesi gjyqësor kundër Pal Aleksit apo Lezhjanit dhe bashkëpunëtorëve të tij, është interesant për faktin se u gjykuan sikur gjoja kishin kryer një krim kundër Zotit, drejtësisë, Republikës dhe gjithashtu edhe pse u kishin shkaktuar telashe pronarëve të anijeve.

Konkretisht, pak para kthimit nga Londra, ata i kishin nxitur detarët e tjerë që të rebeloheshin, duke kërkuar dyfishimin e rrogës, duke krijuar një bashkim (seta), drejtuesi apo “mbreti” i së cilës ishte Pali. Ky bashkë me shpurën (comitiva) e tij kishin drejtuar një kortezh nëpër rrugët e Londrës duke mbajtur në dorë flamurin e galerës Leona, duke ofenduar eprorët e tyre e madje duke thënë fjalë kundër nderit të shtetit të Venedikut. Ata e kishin detyruar të dërguarin e pronarëve, Bertuccio Bonci, që të përulej përpara “mbretit” Pal, duke hequr kapelen e duke rënë në gjunjë, në nderim të tij. Pali akuzohet se e kishte shpallur veten mbret dhe kishte sfiduar haptazi Sinjorinë, madje kishte kërcënuar detarët e tjerë që të mos guxonin të pranonin ofertat e pronarëve¹³.

¹¹ S. Piasentini, “La setta di Londra ...”, f. 514; ASV, Senato misti, v. Xliii, 8 janar 1396, fl. 190; *CSP Venice I*, nr. 119. Dekret i Senatit për të bërë gati katër galera, më të mirat e arsenalit, për udhëtimin e Flandrës. Dy duhej të shkonin në Sluis, dhe dy në Londër. Të qëndronin aty 50 ditë pa përfshirë ditën e mbërritjes dhe të nisjes. Në rast se kjo kohë shtyhej kapiteni gjobitej me 400 dukatë.

¹² Galerat tregtare të linjave të rregullta në shekulin XV kishin një ekuipazh që shkonte në 205-216 persona, prej të cilëve 165-171 remëtarë me rrogë dhe 30 ushtarë. A. Sacerdoti, “Note sulle galere da mercato veneziane nel XV secolo”, f. 81; W. Cunningham, *Growth of English Industry and Commerce ...*, f. 426.

¹³ “Et dum ser Bertucius Bonci homo consilij galee Leona foret missus per dictos patronos ad reconciliandam dictam setam et ortandum quod se Reducere ad galeas, Jpsum ser Bertucium oportuit genu flexo et nudo capite Loqui dicto paulo regi et facere magnam Reuerentiam... Jpse paulus Rex et alia capita cum banderia

Ajo që bën përshtypje këtu është se kërkesat e të revoltuarve nuk ishin vetëm ekonomike, por shkuan deri aty sa të refuzojnë jo vetëm pagesën e ulët, por edhe eprorët e tyre, e madje duke deklaruar haptazi se nuk pranonin t'u bindeshin ligjeve venedikase. Të revoltuarit mbajtën një mbledhje dhe krijuan një këshill drejtues. Dy cilësimet të cilat dalin në procesin gjyqësor janë të rëndësishme për faktin se e para “comitiva”, përdorej në Venedik për të cilësuar shpurat mbretërore, ndërsa tjetra “seta”, me një nënkuptim fetar, por që në Venedik përdorej edhe për cilësimin e bashkësive që tentonin të dilnin kundër regjimit aristokratik¹⁴. Këshilli i të Dyzetëve e dënoi Palin dhe tre bashkëpunëtorët më të ngushtë të tij me 5 vjet burg dhe përjashtim përjetë nga territoret e Venedikut¹⁵.

Interesant është edhe fakti që organizimi i drejtimit të revoltës del i ndarë në tre, sipas etnive që përbënin bashkësinë e rremëtarëve, por ajo që ia vlen të nënvizohet është se Pali që deklarohet si “mbret” i shqiptarëve mban drejtimin e përgjithshëm të revoltës, edhe pse i ndihmuar nga Boncio, kryetar i skiavonëve, dhe Kavalier drejtues i latinëve, venecianëve e grekëve¹⁶. Kjo ndarje, në të cilën Pal shqiptari, mban drejtimin e përgjithshëm nënkupton se shqiptarët ishin grupi më i

displegata, euntes per medium ciuitatis Lundre, cum magno strepitu”. AAV, I/3, nr. 673, f. 46. Kortezihi shëtiti nga një manastir i quajtur Santa Caterina, deri në një “locum et monasterium vocatum sanctum Petrum de Comestier”. S. Piasentini, “La setta di Londra”, 516-17, me të drejtë mendon se bëhet fjalë për vendin që sot është St. Katharine Docks, ndërsa toponimin tjetër nuk arrin ta identifikojë. Veselin Kostić, *Dubrovnik i Engleska. 1300-1600*, Beograd: Srpska Akademija Nauka i Umjetnosti [SANU], 1975, f. 75, e identifikon saktë këtë toponim, si *Sanctus Petrus de Cornestreet*, në zonën e Cornhillit.

¹⁴“dictus paulus creates fuit Rex dicte sete et comitiue, vtentibus ipsis inhonestis, uulgaribus et verbis contra honorem et statum dominacionis”. AAV, *po aty*, nr. 673, f. 46.

¹⁵“quinque annis in vno carcerum Inferiorum. Et postmodum baniatur perpetuo de venetijs et districtu et de omnibus terris et Locis subiectis comuni veneciarum”. AAV, *po aty*, nr. 673, f. 47.

¹⁶“Reduxerunt se ultra quoddam monasterium vocatum santa badia super vno monticulo, et Jbi facto consilio suo, prefatus Paulus creatus fuit Rex Albanensium, Jacobus uero caualier factus fuit capitaneus Latinorum venetorum et aliorum Grecorum, Boncius uero de Ragusio factus fuit capitaneus sclauorum.” AAV, *po aty*, nr. 673, f. 45.

madh në numër nga të tre grupet¹⁷.Duket se revolta nuk kishte shkuar në kundërshtim me rregullat e shtetit anglez dhe as të qytetit të Londrës. Nuk kemi mundur të gjejmë asnjë të dhënë në lidhje me këtë incident në dokumentet angleze¹⁸.

Zhvillimi i kësaj revolte të udhëhequr nga shqiptari Pal, ka shumë elementë që e përafrojnë me atmosferën politike të Londrës së fundit të shek. XIV. Edhe pse S. Piasentini e vë në dyshim mundësinë që “mbreti” shqiptar në Londër të ketë qenë në dijeni rreth predikimeve të Xhon Uiklif (John Wycliffe: 1320-1384), duke u mbështetur në supozimin se qëndrimi 50 ditor në Londër, qoftë edhe në se do të ketë qenë edhe më përpara aty, ishte i pamjaftueshëm për Palin dhe shokët e tij për të njohur predikimet e mendimtarit anglez¹⁹, në të vërtetë faktet dëshmojnë se këto mësimë kishin mbërritur në bregun lindor të Adriatikut, vite më përpara se revolta e drejtuar nga “mbreti” Pal.

E kemi fjalën konkretisht për ngjarjet që ndodhën në Split në fundin e shek. XIV, që ishin të frymëzuara drejtpërdrejt nga predikues të mësimëve uiklifiane. Uiklifi njihet më së pari si një reformator fetar që në shkrimet e tij fetare e politike kritikoi autoritetin e Papatit dhe të Kishës në përgjithësi. Sipas tij, ishte e panevojshme që Kisha të zotëronte prona. Revolta Fshatare në Angli e udhëhequr nga Uat Tajler (Wat Tyler), u frymëzua gjerësisht nga mësimet e Uikliferit²⁰.

¹⁷ Alain Ducellier, “Les Albanais a Venise aux XIVe et XVe siècles”, *Travaux et mémoires*, 2, Paris, 1967, f. 410, duket se e sheh këtë peshë të shqiptarëve në revoltë si jo aq të rëndësishëm, kur pohon që në revoltë “est compromis, à côté de plusieurs Ragusains, le nommé “Paulus Alesii Albanensis”.

¹⁸ Nga 230 raste të faljes për krime të ndryshme të kryera nga të huajt në Angli gjatë mbretërimit të Richardit II, 16 janë italianë, por asnjë prej tyre nuk ka lidhje me rastin e mësipërm. *Calendar of the Patent Rolls Preserved in the Public Record Office. Prepared under the Superintendence of the Deputy Keeper of the Records*. London: Her Majesty's Stationary Office, 1895-1905. Vëll.I, 1377-1381, London: 1895, f. 316, 365; vëll.II, 1381-1385, London: 1897; vëll.III, 1385-1389, London: 1900, f. 44, 133, 333, 334, 501; vëll.IV, 1388-1392, London: 1902, f. 70.313; vëll. V, 1391-1396, London: 1905, f. 15, 227, 282, 675; John L. Leland, “Aliens in the Pardons of Richard II”, në *Fourteenth Century England*, vol. IV, ed. J. S. Hamilton, Woodbridge: The Boydell Press, 2006, f. 136-145.

¹⁹ S. Piasentini, “La setta di Londra ...”, f. 519.

²⁰ George Macaulay Trevelyan, *England in the Age of Wycliffe*. London: Longmans and Green, 1920, f. 80-81, ku shton se mësimet e Uikliferit “contained the germ of Presbyterianism” dhe se fillimisht më 1377, “the government and people of

Në vitin 1383, pra më se një dekadë më herët se sa revolta e udhëhequr nga Pal Aleks i anglez i quajtur Gualter apo Valter (Gualterius) mbërriti në Split. Ky anglez përshkruhet në dokumentet e kohës si “hereticus manifestus”. Ky Valter doli të ishte një predikues i aftë që bëri shumë mbështetës në mesin e masave popullore të Splitit, duke i nxitur fshatarët që të mos paguanin të dhjetën dhe detyrimet e tjera ndaj kishës, dhe duke bërë predikime haptas kundër disa prej dogmave të kishës katolike²¹.

Arsyet që e kishin çuar këtë predikues të vinte nga Anglia në Dalmaci, janë të panjohura, por dimë se, Dalmacia dhe prapatoka boshnjake ishin të njohura në mbarë Europën për përkrahësit e shumtë të bogomilizmit²². Madje, duhet shtuar se ndikimet e herezive mesjetare janë dokumentuar edhe në tokat e banuara nga shqiptarët²³. Dihet se mbas revoltës së Uat Tajlerit, mbështetësit e revoltës dhe predikuesit e ideve të saj filluan të përndiqen nga shteti anglez dhe shumë prej tyre u detyruan të emigronin. Revolta e vitit 1398 në Split duket se ishte shpërthimi i një fushate predikuese disa vjeçare të anglezit Valter²⁴, pothuajse një dekadë

England were both on his side. He was never in his life so strong as he was in this year, when he stood as the national champion against the Papacy, and spoke the national feeling against the abuses of the Church at home... In later years, when he expounded one by one the doctrines peculiar to later Protestantism, he formed a powerful sect, but he ceased to lead the nation or to enjoy the patronage of the government”.

²¹ Ivo Mardešić, *Hrvatska-Velika Britanija. Povijest kulturnih i književnih odnosa*, Zagreb: Biblioteka Relations, 1995, f. 136.

²² Mardešić, *Hrvatska-Velika Britanija*. f. 228, hedh idenë se John Wycliffe duhet të ketë pasur dijeni rreth situatës fetare në Dalmaci përmes veprës *Chronica Anglorum* të Mathew Paris, vdekur më 1259, ku përfshihet një letër e legatit papal Konrad, i cili duke folur për albigjencët thotë se ata kishin papën e tyre dikund “in finibus Bulgarie, Croatie et Dalmatie, iuxta Hungarorum nationem”.

²³ Dhimitër S. Shuteriqi, “Shënim mbi herezinë mesjetare në Shqipëri”, *Studime historike*, nr.2, 1980, f. 205, mendon se “gjeografikisht, Shqipëria ka qenë në epiqendrën e lëvizjes “së re” heretike të Evropës, bashkë me Maqedoninë”.

²⁴ *Arkivi i Splitit*, Conscriptio manuscriptorum, SE. D. br. 669. “quod subductionibus et subversionibus iniquitatis filii Gualterii de Anglia, heretici manifesti, qui diabolicis spiritibus instigatus non veretur quam plura populo contra Christi fidem et precepta sacrosancte matris ecclesie in ipsius ac astantium animarum detrimentum et perditionem dampnabilem publice predicare. Qui inter cetera vetat et predicat decimas, elemosinas et ecclesiarum redditus et proventus clericis et presbiteris exhiberi debere propter que maior pars populi spalatensis est

më herët se sa idetë e Uiklifit të depërtonin në Bohemi në formën e husitizmit²⁵.

Edhe Mbreti i mëvonshëm i Anglisë Henri Bolingbroke i dinastisë së Lankaster, që u shpall Mbret Henri IV më 1399, në vitet 1392-1393 dihet se ka qëndruar në Dalmaci, në Zarë dhe Dubrovnik gjatë pelegrinazhit për në Jeruzalem²⁶. Po ashtu, pak vite më vonë në kryqëzatën e Nikopolit kundër osmanëve, Henri Bolingbroke mori pjesë me një trupë prej njëmijë kalorësish anglezë. Mbas disfatës u kthye në bordin e anijeve venedikase në Venedik²⁷.

Ka të ngjarë që komandanti ushtarak anglez që dëshmohej në Shkodër në fillimin e shek. XV të ketë mbetur në shërbimin e Venedikut gjatë këtyre vizitave të Henrit IV në Adriatik. Ky Xhon Anglezi (Zuane Engelese apo Johannes Anglicus), mercenar dhe komandant i mercenarëve në zonën e Shkodrës në gjysmën e parë të shek. XV, del edhe si zotërues tokash në rrethinat e Shkodrës, siç është fshati Gleros (Garuc?), në vitin 1417, megjithëse Senati e kishte ndaluar praktikën e shpërblimit të mercenarëve me prona feudale²⁸. Mbas vdekjes së tij, autoritetet venedikase ia kishin dhënë pronën e Xhonit personave të tjerë, në kundërshtim me të drejtën e bashkësisë shkodrane. Si pasojë vite më vonë, trashëgimtarët e tij kërkojnë që t'u kthehet e drejta²⁹.

subversus in tantum quod neque decimas neque elimosinas neque possessionum ecclesiasticarum fructus, redditus et proventus clericis et ecclesiarum rectoribus et ministris dare nolunt". Miroslav Brandt, *Wyclifova hereza i socijalni pokreti u Splitu krajem XIV. St.* Zagreb: Kultura, 1955, f. 238.

²⁵ M. Brandt, *Wyclifova hereza i socijalni pokreti u Splitu ...*, f. 177-231.

²⁶ Veselin Kostić, *Kulturne veze između jugoslovenskih zemalja i Engleske do 1700. godine*, Beograd: SANU, 1972, f. 279; Mardešić, *Hrvatska-Velika Britanija ...*, f. 135. Që prej vitit 1389 kishte një armëpushim mes Anglisë dhe Francës, që vazhdonin luftën, që më vonë u quajt Lufta Njëqindvjeçare. Henri Bolingbroke, shoqërohej nga 300 kalorës anglezë, dhe ndaloi në brigjet ballkanike si Zara, Liesina, Raguzë dhe Korfuz.

²⁷ R. Brown, *CSP, Venice*, I, shën.64-65.

²⁸ Ngaqë i ishte dhënë nga Këshilli i Lartë (AAV, II/8, 21 Mars 1417, nr. 2134), prandaj «el Consejo de pregadi non possa rompere quelle cosse che ha facto el Grande consejo». *Senato Misti* LI, c. 153v. Ivan Božić, "Le système foncier en "Albanie vénitienne" au XVe siècle", *Bollettino dell' Instituto di Storia della Società e dello stato veneziano*, 5-6, 1963-1964, f. 86.

²⁹ "Johannis Anglici capitis gentium nostrarum armigerarum in Scutaro". AAV, II/16, 10 nëntor 1441, nr. 3992. Në këtë vit Xhoni kishte vdekur, por trashëgimtarët

Lidhur me praninë e shqiptarëve në portin tjetër të rëndësishëm anglez, Southampton, një nga burimet më të çmuara për njohjen e pranisë së të huajve, mes tyre edhe shqiptarëve në këtë qytet, ishin regjistrat doganorë të portit, të quajtur *Port books*, dhe që janë ruajtur pjesërisht. Të dhënat e këtyre regjistrave janë veçanërisht me interes, për numrin relativisht të madh të shqiptarëve që dalin në këto regjistra, për aktivitetin dhe rolin e tyre në jetën e këtij porti të rëndësishëm anglez si edhe për gjeografinë e trevave nga vinin këta shqiptarë, por edhe për faktin se kjo prani e shtuar e detarëve shqiptarë në Southampton përkon me fazën e fundit të tregtisë së lulëzuar të italianëve në Detin e Veriut dhe në të njëjtën kohë me fazën e fundit të lulëzimit të portit të Southamptonit.

Pozita gjeografike në jug të Anglisë e ka favorizuar gjithnjë këtë port, por shtysën më të madhe zhvillimit të tij ia dha ardhja e flotave tregtare të qyteteve italiane, veçanërisht të Venedikut, Firences e Gjenovës. Shkak për rritjen e rëndësisë së Southamptonit në tregtinë e venedikasve ishin revoltat kundër tregtarëve të huaj që ndodhën në Londër më 1456³⁰. Southamptoni shërbente si bazë për tregtarët e mëdhenj italianë si qendër grumbullimi e eksportimi e leshit dhe tekstileve të jugperëndimit të Anglisë, si treg për lëndën e parë të industrisë tekstile të kësaj zone, si port i jashtëm i Londrës në zonën e Kanalit të La Manshit dhe si port transit për tregtinë e artikuljeve të luksit të Mesdheut dhe të Lindjes që e kishte qendrën në Londër³¹.

Natyrisht, duhet bërë dallimi mes kolonisë italiane në port që ishin ngulitur aty dhe një numri shumë më të madh vizitorësh kalimtarë nga portet e Mesdheut që përbëhej nga një popullsi ambulante pronarë anijesh, kapitenësh dhe marinarësh nga galetë dhe anijet e ankoruara në port. Qëndrimi i tyre në qytet shkonte nga disa ditë deri në tre apo katër muaj në rastin kur këto anije dimëronin në port. Megjithëse numri i tyre ishte relativisht i madh, ata luanin një rol shumë më të vogël në jetën e qytetit se sa kolonia e vogël e përhershme e tregtarëve italianë. Në Southampton venedikasit kishin si qendër të praktikave fetare dhe si vendvarrimi kishën e Shën Nikollës. Këtu po ashtu ndodhej edhe varreza

e tij, e bija e martuar me Kolë Humojn, në emër të dy djemve të saj, Radit e Marin, kërkonte të gëzonte të drejtat ndaj fshatit Gleros.

³⁰ Colin Platt, *Medieval Southampton. The Port and trading Community. A. D. 1000-1600*, London and Boston: Routledge & Kegan Paul, 1973, f. 171; A. Ruddock, *Italian Merchants and Shipping in Southampton*, f. 66, 188.

³¹ A. Ruddock, *Italian Merchants and Shipping in Southampton ...*, f. 97.

e bashkësisë së remëtarëve sklavonë e dalmatas që vdisnin gjatë qëndrimit në port³².

Të dhënat fiskale të portit të Southamptonit, për vitet 1427-1430 dhe 1435-1436 nuk na japin asnjë të dhënë mbi praninë e shqiptarëve³³. Kjo ka të bëjë edhe me faktin që regjistrat e hershëm, sidomos të viteve 1427-1430, japin shumë pak detaje. Përkundrazi, në regjistrat e mëvonshëm, duke filluar nga viti fiskal 1439-1440³⁴, shqiptarët janë gjithnjë të pranishëm. Kështu, në regjistrat e vitit 1439-1440 në galenë ku Francesco Dandolo ishte pronar dhe që regjistron hyrjen në port më 4 prill 1440³⁵, dalin të kenë kryer veprime tregtare, Gjergj Durrsaku, Gjergji nga Palasa, Perdolsimo nga Lodrini, Gjergji nga Danja, Gjon Bushati, Luka Trushi, Gjoni nga Danja, Dimitri nga Barbullushi, Gjoni nga Drishti, Martini nga Lodrini, Gjoni dhe Dimitri nga Lezha³⁶. Në galenë me pronar Luce

³² Varreza e tyre ishte shënuar me një gur varri me një shqiponjë dykrenare në mes të vendosur në një mburojë me një engjell, një dem me krahë, një shqiponjë dhe një luan me krahë, me mbishkrimin: "Sepultura de la Scuola de Slavonia. Ano Dm MCCCCLXXXI. A. Ruddock, *Italian Merchants and Shipping in Southampton ...*, f. 133.

³³ *The Port Books of Southampton, or (Anglo-French) Accounts of Robert Florys, Water-bailiff and Receiver of Petty-customs, A.D. 1427-1430*, Edited by Paul Studer, Southampton: Cox & Sharland, 1913; *The local Port Book of Southampton, 1435-36*, Edited by Brian Foster, Southampton: The University Press, 1963.

³⁴ Viti fiskal anglez fillonte më 29 shtator.

³⁵ Kjo galerë regjistron daljen nga porti më 26 prill (fls. 77r-80r), dhe dokumentohet se ka mbërritur në portin e Sandwich më 11 dhjetor 1439, duket për t'u bashkuar me galerat e Londrës në udhëtimin e kthimit për në Venecia. *The National Archives*, (më tej: TNA), Customs Accounts, Sandwich, 127-18.

³⁶ George Durasse, 1 coverlett; George de Palase, 1 barello saponis nigri; Perdolsimo de Lodrin, 3 ketells 1 dosyn patellis eneis parvis; George de Deyna, 1 dosyn et di. de sporis, 10 candelabris, 10 patellis eneis, 5 dosyn cultellorum et 3 dosyn gederdell; Johanne Bussate pro 10 banquers et 2 coverlett', 7 grosys poynt', 3 dosyn cultellorum et 30,000 pynnes; Luka Tose pro 1 dosyn et di. de sporis 3 ketels 12 dosyn myrrours 5 dosyn gerdell 5 dosyn cultellorum; Johanne de Deyna pro 6 banquers 6 ketels; Demytrio de Barbalose pro 4 ketels 10 dosyn 2 grosys lasys, 1 grose point, 2 dosyn gerdell, 6,000 pynnes; Johanne de Drivaste pro 1 dosyn et di. de pochis et 1 dosyn cultellorum, 14 vergis panni linii; Martyno de Ludrino pro 13 lb. Piperis; Johanne de Lessho pro 13 lb piperis; Demytrio de Lessho pro 16 dosyn cultellorum, 1 dosyn sher', 2 dosyn candelabrum; 2 dosyn pochys, 3 chaffer', 1 dosyn ketels, 3 dosyn patellis enei. *The Local Port Book of*

Bembo që regjistron daljen nga porti më 26 prill 1440 bashkë me 11 të tjerë jo shqiptarë del edhe Matheo Topias³⁷.

Në numër shumë të kufizuar shqiptarët janë të pranishëm jo vetëm në flotën e Venedikut, por edhe të shteteve të tjera italiane, konkretisht Gjenovës. Për t'u theksuar është fakti se në anijet gjenoveze shqiptarët nuk identifikohen me qytetin apo zonën e origjinës, por me etnonimin shqiptar (Albanese, albaniso). Për këtë arsye të dhënat që dalin nga anijet venedikase, përveçse më të shumta, janë edhe shumë më të detajuara³⁸. Kjo është e kuptueshme mbasi për gjenovezët që ishin gjeografikisht dhe politikisht larg Shqipërisë, nuk kishte kuptim identifikimi nëpërmjet qytetit apo zonës prej nga vinte nga Shqipëria, por thjesht që vinte nga Shqipëria. Kështu në anijen gjenoveze me pronar Armaregi Carnesik që hyn në Southampton më 19 qershor 1478, ardhur nga Flandra, del Nicholo Albaniso³⁹. Po ashtu edhe në galerën tjetër gjenoveze, që udhëtonte bashkë me të parën, dhe që hyn në port në të njëjtën ditë, me

Southampton for 1439-40, (më tej *LPBS, 1439-40*), Edited by Henry S. Cobb, Southampton: At the University, 1961, *Liber Alien*, fl 76r-80r.

³⁷ « 4 pannis lanii ». *LPBS, 1439-40*, *Liber Alien*, fl 82r.

³⁸ Për shembull në galerën e Jeronimus Moresyn mbërritur në Southampton më 9 prill 1461, dalin detaje për praninë edhe të shqiptarëve nga zona të brendësisë shqiptare si Michele de Tebenet (?), Matheo de Carraba (Kërraba), përkrah me Staco de Seint George, (Shën Gjergji), Alegretto de Lago, Georgio Summe. TNA E122/142.1; *PBS*, II, 1477-1481, Appendix I; Në galerën e Georgins Remond, po më 1461, përveç Luco dhe Nadall de Seint George, Petro de Scotere, Georgio de Summe, Nicholao de Scotere, Luco de Scotere, Alegretto de Lago, Paulo Lodryn, Alesse de Ludryn, Lupo de Scutte dalin edhe Mikel Hoti (Michelle Hote), Rado nga Shtodri (Rado de Seint Todiro, toponim që dëshmohej edhe sot mbi fshatin Mes, ndërmjet Shkodrës e Drishtit), Gjergj Shiroka (Georgio Seroca). TNA, E122/142, I; *PBS*, II, 1477-1481, Appendix I, f. 201-202. Ndërsa në galerën e Dominicus Trvisan dëshmohej përveç Allegrato de Scoter edhe Stephano Busshet, (Bushati), Gjergji nga Gajtani (Georgeo de Gayt), Francisco Seint George, (Shën Gjergji) e Allegrato de Seint John, (Shëngjin), *PBS*, II, 1477-1481, Appendix II, 1463- 1464, f. 206.

³⁹ *PBS*, II, 1477-1481. Book E, *Liber Alienigenus*, 1477-1478, fl. 30. Në mesin e 84 personave të regjistruar në këtë gale, (fl. 30-30v), vetëm ky mund të identifikohet saktësisht si shqiptar.

pronar Johannes Symond Tornabone dalin Georg' Albanise dhe Martin' Albaniso⁴⁰.

Ndodhte që shqiptarët të mbërrinin në Angli edhe në bordin e anijeve të tjera, siç është rasti i një drishtjani që mbërrin në Southampton në një anije portugeze. Kështu, në anijen në të cilën portugezi Zhoao Martinjo (John Martin) ishte pronar, mbërritur më 10 tetor 1469, Meure Drygust, pagoi detyrimet doganore për 6 papagaj, një mall luksoz në atë kohë⁴¹. Kjo përforcohet edhe nga fakti që kjo anije regjistron vetëm dy veprime tregtare, atë të Marin Drishtjanit dhe të Srapero nga Lisbona (Srapero de Lusshebone). Kjo është e kuptueshme, mbasi rruga për në Angli e Flandër kalonte nëpër brigjet portugeze, megjithëse ka edhe raste shqiptarësh që duhet të kenë vizituar bregun atlantik të Spanjës, duke përdorur rrugët tokësore, siç është rasti i Nikollës nga Drishti, që del të ketë shkuar si pelegrin në shenjtoren e Shën Jakut, në Santiago de Kompostela, në Galicia, më 1349⁴².

Përveç burimeve angleze, edhe burimet venedikase e konfirmojnë këtë pasqyrim të shqiptarëve në flotën e Flandrës. Një nga këto burime është ditari i mbajtur në bordin e galeve i priftit-noter Giovanni Manzini, ndërmjet viteve 1471-1486. Në këtë ditar, që natyrisht ka një natyrë krejt tjetër nga ajo e regjistrave portualë anglezë, dalin disa shqiptarë. Kështu

⁴⁰ Të njëjtat arsytetime si më sipër vlejné edhe në rastin e kësaj galeje gjenoveze. Kjo gale më 17 gusht 1478 regjistron daljen nga porti me destinacion Mesdheun. *PBS*, II, 1477-1481. Book E, Liber Alienigenus, 1477- 1478, fl. 35v.

⁴¹ *Port Books of Southampton for the Reign of Edward IV*, edited by D. B. Quinn and A. A. Ruddock, vëll. I, 1469-1470, Southampton: Cox& Sharland, 1937. (më tej: *PBS*, I, 1469-1470), fl. 2.

⁴² Në një dokument të Raguzës të vitit 1349, lexojmë se ky drishtjan zotohej të kryente pelegrinazhin në Galicia, për shpirt të Franit, argjendar raguzas: "Dompnus Nicola de Driuasto facit manifestum quod promittit et se obligat Priboe de Torden, pitropo Frane aurificis, de eundu ad Sanctum Jacobum de Galicia pro anima ipsius Frane. Et hoc promissit pro yperperis XLIII". Kjo pohohet edhe në testamentin e Franit ku thuhet: "mandassimo uno prevedo a nome dom Nicola de Driuasto et sibi dessimo perperos XLVIII per l'anima de Frane per andar a Galiçia". *Acta et diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*, collegerunt et digesserunt Ludovicus de Thallóczy, Constantinus Jireček et Emilianus de Sufflay, volumen II, (annos 1344-1406 continens), Vjenë: Adolph Holzhausen, 1918, f. 14, nr. 47; Ardian Muhaj, "Elementos étnicos minoritários na zona de Shkodra durante o domínio veneziano", *Iacobus. Revista de estudios jacobeos y medievales*, Centro de Estudios del Camino de Santiago, nr. 15-16 (2003), f. 230.

në udhëtimin e vitit 1471-1472 del Gjoni nga Lezha⁴³, Novello nga Liqeni (i Shkodrës)⁴⁴, Stefan Kërroqi⁴⁵, Marini nga Shkodra⁴⁶ dhe Nikollë Muriqi⁴⁷.

Natyrisht që rruga e gjatë që galehtë e Flandrës përshkonin ishte e mbushur me peripeci e rreziqe të shumta. Përkundër faktit që galarat venedikase të Flandrës ishin ndër anijet më të sigurta dhe më të armatosura të kohës kishte raste kur edhe ato binin pre e piratëve⁴⁸. Në

⁴³ Lucia Greco, "Sulle rotte delle galere veneziane: Il cartulario di bordo del prete notaio Giovanni Manzini (1471-1486)", *Archivio Veneto* (1991), f. 5-37; *Quaderno di bordo di Giovanni Manzini prete-notaio e cancelliere (1471-1484)*, bot. Lucia Greco, Venezia: Il comitato editore, 1997. ASV, Canc. inferiore, busta 124.

⁴⁴ 13 maj 1472. Southampton: "E questo provò esser creditor per Novello da Lago condan Nadal, Stefano Charuzi condan Zorgi". *Quaderno di bordo di Giovanni Manzini prete-notaio ...*, f. 13.

⁴⁵ Agostino Pertusi, "Per la storia di Dulcigno nei secoli XIV-XV e dei suoi statuti cittadini", *Studi veneziani*, 15, 1973, f. 241, "villa de Charuzzi" në rrethinat e Ulqinit e identifikon me Kërroqi.

⁴⁶ 12 shtator 1472 Messina: "sier Marin da Schutari coram me notario et testium infrascriptorum vendidit... sedam nominatam spagnollam Armarie". *Quaderno di bordo di Giovanni Manzini prete-notaio ...*, f. 21.

⁴⁷ 19 shtator 1472. Del si dëshmitar në testamentin e "Ser Nicholaus Stela". *Quaderno di bordo di Giovanni Manzini prete-notaio*, f. 21. Manzini gjithashtu jep edhe itinerarin e flotës veneciane të përbërë nga katër gale. Kështu galehtë veneciane u ndalën në Southampton, Londër, Sluis në Hollandë, Kadis dhe Almeria. Lucia Greco, "Sulle rotte delle galere veneziane", f. 14-15.

⁴⁸ Situata e sigurisë në det përkeqësohej kryesisht në periudhat e konflikteve mes shteteve të ndryshme, sidomos kjo vlen për luftën njëqindvjeçare, ndërmjet Francës e Anglisë. Kështu në situatën e krijuar nga ashpërsimi i këtij konflikti në kohën e betejës së Crecy (1346), Senatit iu desh që disa herë të anulonte nisjen e flotës së Flandrës. *Venezia-Senato. Deliberazioni miste*. A cura di Maria Francesca Tiepolo, Dieter Girgensohn, Gherardo Ortalli. Venezia: Istituto Veneto di Scienze, Lettere ed Arti, 2004-2007. 12 vëllime. *Registro XXIV (1347-1349)*, vëll. 11. doc. 94, (17 prill 1347). "litteris que venerunt de Flandria et habito respect ad novitates que occurrerunt in partibus illis et ad magna et ardua pericula maris iminentia undique presentialiter, ut audistis, habitaque colatione cum patronis galearum Flandrie, qui de infrascriptis contentantur, consulunt quod in nomine Domini viagium remaneant et non vadant"; *Po aty*, vëll. 11, doc. 99. "manifeste sunt omnibus notoria pericula maxima incumbent galeis et hominibus et bonis earum que debeant ire ad viagium Flandrie nec etiam pro viagio earum terra consequatur

një sulm të tillë piratesk, Paskalini nga Shkodra që kishte nisur të lundronte që në moshë të renë flotën venedikase, ndërsa ndodhej në një nga galerat e Flandrës rreth vitit 1445, u plagos rëndë nga piratët, duke mbetur invalid përjetë⁴⁹.

Disa qartësime rreth shqiptarëve në Angli

Është e kuptueshme që në mungesë të studimeve rreth pranisë së shqiptarëve në territoret angleze në mesjetë, që disa autorë të shquar kanë identifikuar gabim, si shqiptarë, persona që dalin në dokumentet e kohës, ose i kanë anashkuar. Një rast i qartë i ngatërimit të panevojshëm është i Tom Olding, që shkodranin Marin Nikolla, “de Scontere”, që del në një proces gjyqësor në Southampton në 1474, e paraqet si të paidentifikueshëm, edhe pse me dyshim mendon që të bëhet fjalë për Scontrone nga zona malore e Abrucos⁵⁰. Ne dimë se ky Marin nga “Scontere”, ishte detar shkodran që del përkrah shqiptarëve të tjerë edhe në raste të tjera. Madjebashkë me Marinin nga Shkodra, dalin në proceset gjyqësore të Southamptonit edhe Domeniku nga Drishti⁵¹, Nikolla nga Drishti dhe Gjergj Drishtjani, ky i fundit madje del dy herë, për arsye borxhesh ndaj dy detarëve të tjerë⁵².

Po ashtu regjistri doganor për vitet 1469-1471, nxjerr në dritë praninë e një numri të konsiderueshëm shqiptarësh, kryesisht rremëtarë e marinarë, që në të njëjtën kohë edhe bënin tregti në Southampton. Një

illam utilitatem... pro obviando predictis periculis... debeant remanere et non vadant”.

⁴⁹AAV, III/21, 19 qershor 1446, nr. 5214.

⁵⁰ “Marino de Nichalao of ‘Scontere’ complains against John Jurdan crossbowman of a certain galley called Manuleseo concerning a plea of detinue of chattels.” TNA.SC 7/1/3, 11 October 1473-26 October 1474, fol. 23r. Tom Olding, *The Common and Piepowder Courts of Southampton, 1426-83*. Southampton: The University of Southampton, 2011, f. 45, pohon: “Unidentified. There are no modern Italian surnames that begin with this sound. The only place that so begins is Scontrone, prov. Abruzzo, high up in the mountains south of Rome”.

⁵¹ “John Leonard complains against Dominic de Drivast concerning a plea of trespass”. TNA, SC 7/1/6, fol. 3r., 2011; T. Olding, *The Common and Pie powder Courts of Southampton*, f. 69.

⁵² Nicholas de Druet complains against George de Druet concerning a plea of detinue namely of a sea-cape part of a load delivered to him here. John Grose complains against George Druet *Galyman* concerning a plea of debt”. TNA, SC 7/1/6, fol. 20v; T. Olding, *The Common and Piepowder Courts*, I, f. 98.

Marin nga Shkodra (Marin de Skutere) del në galene e Jeronyme Deodos, mbërritur më 12 prill, ku shet krehra fildishi, coha të ngjyrosura, thika, tjerrese të pikturuara⁵³ dhe blen në këtë port pëlhura të pangjyrosura dhe lëkura të regjura⁵⁴.

E dimë se bëhet fjalë për një shkodran ngaqë nuk del i vetëm, por në mesin e shqiptarëve të tjerë si Stefani nga Drishti, Toma nga Shengjoni apo Shengjini, Gjergji nga Shkodra, Pali nga Shkodra dhe Andrea nga Lezha⁵⁵. Edhe në galerën e Marco Trevisanit të regjistruar më 9 maj të të njëjtit vit, dalin të tjerë shqiptarë si Stephano Brusete (Brusato), që shet 2 sënduqe, 24 copë kersey⁵⁶, 3 dëngje mëndafsh e pëlhura të pangjyrosura⁵⁷, Antone Meda, pëlhura, Nycolo Sumba, po ashtu⁵⁸, Jorge de Skutere, lëkura viçi⁵⁹, Mykaell Albonesse, coha të pangjyrosura, John de Skutere, pëlhura kersey, Mark Trushi pëlhura, dhe enë kallaji⁶⁰. Në galenë e Nycholao de Peysero, hyrë më 30 nëntor 1469, dalin Gjoni nga Shati apo Shasi⁶¹, Juliani nga Danja⁶² dhe Bartolome Vlonjati⁶³.

⁵³ “painted cards”, bëhet fjalë për pajisje dore për përpunimin e leshit, lloj krehërash që përdoreshin për të tjerrur leshin, apo pambukun.

⁵⁴ *PBS*, I, 1469-1470, Book B. (L. Alienigenus), fl. 13-14, p.57- 58, 15-23 qershor.

⁵⁵ Stephano Dryvest që shet kinkalerina, stafidhe apo rrush thatë Korinti, melasë; Thomas de Senjone, gjilpëra e kapëse; Jorge de Skutere, kinkalerina. Povlo de Skutere, kinkalerina, stafidhe Korinti; Andrea de Lesso, fije liri, mëndafsh të papërpunuar, shtiza për thurje, kapëse dhe karfica. *PBS*, I, 1469-1470, Book B. (L. Alienigenus), fl. 3-8.

⁵⁶ “Kersey” ishte një pëlhurë leshi dhe e kishte marrë emrin nga fshati Kersey në Suffolk

⁵⁷ *PBS*, I, 1469-1470, Book B. (L. Alienigenus), fl. 10, 29 maj. Po ky më 6 qershor paguan doganë për mallra të tjera, kryesisht pëlhura e lëkura (fl. 10v), më 9 e 16 qershor, (fl. 10v), më 23 qershor, (fl. 12) dhe më 26 qershor. (fl. 12)

⁵⁸ *Po aty*, fl. 10v. Po ashtu më 19 dhe 22 qershor, pëlhura (fl. 11- 11v).

⁵⁹ *Po aty*, fl. 11. 18 qershor, kurse më 23 qershor, pëlhura kersey (fl. 12).

⁶⁰ *Po aty*, fl. 10-12v.

⁶¹ John de Sato, shet shporta dhe fiq të thatë. *PBS*, I, 1469- 1470. Book B. (Liber Alienigenus), f. 1v.

⁶² Juliano Daina, shet ngjyrosës pëlhurash, rrëshirë dhe kokrra parajse. (Lloj erëze, farë e bimës *Aframomum melegueta*). *Po aty*, f. 2.

⁶³ Bartolomew Valorens, pëlhura të pangjyrosura. *Po aty*, fl. 12v, 9 maj.

Po ky Marin nga Shkodra dhe jo nga Scontrone, del sërish në regjistrat e Southamptonit vite më vonë në nëntor të vitit 1477, në galenë e Petrus Marcel, bashkë me shqiptarë të tjerë nga Drishti e Shkodra⁶⁴.

Një rast tjetër me rëndësi është ai i Gjon Drishtjanit (Giovanni da Drivasto). Identifikimi sa më i qartë i këtij detari është i një rëndësie të veçantë për historinë detare të shekullit XV. Ky detar nga Drishti, ka pasur në zotërim dhe na ka lënë trashëgim dorëshkrimin më të vjetër që ekziston rreth teknologjisë së ndërtimit të anijeve. Bëhet fjalë për dorëshkrimin e hartuar nga detari Mikel nga Rodi në vitet 1434-1443⁶⁵. Historia e këtij dorëshkrimi mbas vdekjes së autorit nis me Gjon Drishtjanin, i cili në vitin 1473 e mbante në arkën e tij të udhëtimit dhe në të cilin Gjoni ka lënë të shkruar edhe testamentin e tij, pikërisht në dy faqet e fundit kur ndodhej në bordin e një galere venedikase, në Halki, një ishull i vogël në afërsi të Rodit, më 29 gusht 1473⁶⁶.

Vetë historia e dorëshkrimit është interesante. Që prej vitit 1473 kur del në zotërim të Gjon Drishtjanit e deri në fillimin e shek. XX, nuk është ditur vendndodhja e tij, megjithëse pjesë nga dorëshkrimi janë kopjuar në shek. XVI dhe janë botuar nga Agustin Jal në vitin 1840, pa u përmendur autori, as pronari apo pronarët që e kanë pasur mbas Gjon Drishtjanit⁶⁷.

Lidhja e tij me dorëshkrimin e Mikelit nga Rodi është zbuluar vetëm në vitin 1966⁶⁸. Edhe sot e kësaj dite dorëshkrimi është në pronësinë e një blerësi privat, që e ka blerë në ankandin e vitit 2000 të qendrës së njohur të ankandeve “Sotheby’s” të Londrës⁶⁹. Në vitin 1949 dorëshkrimi është përshkruar shkurtazi në katalogun e librarisë Beaux Livres të Nicolas

⁶⁴ Marino de Scutere, verë, vaj. Johanne de Scuter, pëlhura e sapun. Petro Dryvers, verë, zenzefil të gjelbër dhe 30 pashë pëlhura të linjta. *PBS*, II, 1477-1481. Book E. (liber alienigenus), 1477-1478, appendix IV, f. 216-219.

⁶⁵ Mikeli nga Rodi del të ketë shërbyer në galerat venedikase për plot 42 vjet, nga viti 1401 deri në vitin 1443. Pamela O. Long, “Introduction: The World of Michael of Rhodes, Venetian Mariner”, në *The Book of Michael of Rhodes. A Fifteenth-Century Maritime Manuscript*. Edited by Pamela O. Long, David McGee, and Alan M. Stahl, Vol. 3. Massachusetts-London: The MIT Press, 2009, f. 1-2.

⁶⁶ Long, “The World of Michael of Rhodes”, f. 28-29.

⁶⁷ Giovanni Battista Ramusio ka kopjuar disa pjesë të njohura si Codice Magliabechiano cl. XIX. cod. 7, Biblioteca Nazionale Firenze, botuar nga Augustin Jal, *Archéologie navale*, Paris: Betrand, 1840, vol. 2, f. 1-133.

⁶⁸ P. Long, “The World of Michael of Rhodes ...”, f. 24.

⁶⁹ Franco Rossi, “Introduction to the Manuscript”, *The Book of Michael of Rhodes*, Vol. 2, f. viii.

Rauch, në Zvicër, me një çmim prej 70.000 franga zvicerane⁷⁰. Më pas, del më 1966, në ankandin e Sotheby's të Londrës ku blihet për 5.500 stërlina⁷¹.

Megjithëse në këtë rast për studiuesit u bë e qartë se dorëshkrimi ishte i një rëndësie të pakrahasueshme, askush nuk arriti ta shfrytëzonte, deri mbas vitit 2000 kur blihet nga zotëruesi i tij i tanishëm⁷². Në këtë rast, zotëruesi i tij pranoi t'i japë lejen e studimit një grupi studiuesish, dhe si rezultat dorëshkrimi është botuar në vitin 2009 në tre vëllime nga MIT Press. Edhe pse studimi dhe botimi i dorëshkrimit është bërë nga një grup ndërkombëtar specialishtësh të shquar nga Italia, Kanadaja, Gjermania dhe SHBA⁷³, vëmë re se në lidhje me Gjon Drishtjanin, këta autorë pohojnë se nuk kanë mundur të gjejnë kurrfarë të dhëne tjetër përveç asaj që vetë Gjoni ka shkruar në dy faqet e fundit të dorëshkrimit⁷⁴, tekst i cili nuk ka lidhje me përmbajtjen e dorëshkrimit, por është thjesht testament i tij.

Sipas vetë asaj që shkruan Gjoni në testamentin e tij në fletët 238a and 238b, ai pohon se ishte “paron zurado” i pronarit Marino Dandolo⁷⁵. Megjithëse dëshmia e Gjonit është shkruar në një ishull të detit Egje, kemi gjetur të dhëna të tjera rreth Gjon Drishtjanit, të dhëna të cilat, sikur të kishin qenë të njohura nga botuesit e dorëshkrimit, padyshim që do t'ia kishin shtuar vlerën atij botimi. Ashtu sikurse Mikeli nga Rodi, i cili kishte shërbyer për 42 vjet në flotën venedikase jo vetëm në Mesdhe, por

⁷⁰ Nicolas Rauch, *Livres précieux et autographes des XVe et XVIe siècles*, catalog no. 2/123. Basel: Benno Schwabe, 1949, f. 123-126.

⁷¹ *Catalogue of Important Western and Oriental Manuscripts and Miniatures*, July 11, 1966, lot 254. London: Sotheby, 1966, f. 89-93.

⁷² *Western Manuscripts and Miniatures*, December 5, 2000, lot 54. London: Sotheby, 2000.

⁷³ P. Long, “Preface to Volume 3 ...”, f. vii

⁷⁴ Botuesit pohojnë se për Gjon Drishtjanin “it has not been possible to find additional information”. F. Rossi, “Introduction to the Manuscript”, f. xxxi. Për përkthimin në shqip të testamentit të Gjonit nga Drishti shih: Edmond Malaj, “Testamenti i Gjonit nga Drishti (Johannes da Drivasto). Dokument i vitit 1473” në *Studime historike*, nr. 3-4, 2012, f. 295-305.

⁷⁵ P. Rossi, “Introduction to the Manuscript” f. xxi. ‘padrone giurato’ ishte personi që lihej si mbikqyrës i remëtarëve ndërmjet pjesës së përparme të anijes dhe direkt kryesor. Camillo Manfroni, “Cenni sugli ordinamenti delle marine italiane del Medio Evo”, *Rivista Marittima* (Romë, 1898), f. 473, 485; A. Sacerdoti, “Note sulle galere da mercato veneziane nel XV secolo ...”, f. 81.

edhe në Europën Veriore⁷⁶, edhe Gjon Drishtjani del të ketë qenë i pranishëm si në flotën e Mesdheut ashtu edhe në Flotën e Flandrës.

Kështu Gjon Drishtjani, i cili dëshmohej për herë të parë në regjistrat e Southamptonit të vitit 1439-1440⁷⁷, del një vit më vonë në mesin e ekuipazhit të galerave venedikase që mbërrijnë në Londër në vitin 1441. E dëshmojnë këtë të dhënat e regjistrave të bujtinave londineze që ishin të licensuara për të strehuar detarët e huaj që mbërrinin në kryeqytet dhe që japin të dhëna të çmueshme rreth shqiptarëve që strehoheshin nëpër këto bujtina, gjatë kohës që anijet e tyre qëndronin në Tamiz. Kështu të dhënat e këtyre regjistrave për vitet 1440-1445, pasqyrojnë praninë dhe aktivitetin tregtar të dhjetëra shqiptarëve në Londër, mes të cilëve del edhe Gjon Drishtjani⁷⁸.

Ai del bashkë me shumë shqiptarë të tjerë në regjistrin e bujtinës së John Welles, mikpritës i ekuipazhit të galesë së Giacomo Corner-it, mbërritur në Londër më 18 tetor 1441, dhe që qëndroi në këtë qytet deri në 26 mars të vitit 1442⁷⁹. Mikpritësi duhej të regjistronte të gjitha aktet e shitblerjes që tregtarët dhe detarët e anijes kryenin në qytet. Sa i përket shqiptarëve, dalin të kenë kryer shitje të mallrave të ndryshme, kryesisht venedikase, Nikolla nga Ludrini⁸⁰, Domeniku nga Buna⁸¹, Vlashi nga

⁷⁶Ka kryer 13 udhëtime në Flandër ose Londër, i pari në 1404 dhe i fundit në 1443. P. Long, "Introduction: The World of Michael of Rhodes ...", f. 13.

⁷⁷Johanne de Drivaste, 1 dosyn et di. de pochis et 1 dosyn cultellorum, 14 vergis panni linii. LPBS, 1439-40, fl. 79r.

⁷⁸Fakti që këto të dhëna dalin vetëm për disa vite ka të bëjë me një dekret të Parlamentit anglez të vitit 1439, dhe që qëndroi në fuqi për shtatë vjet duke filluar nga prilli i vitit 1440.

⁷⁹*The views of hosts of alien merchants. 1440-1444*, Edited by Helen Bradley, Woodbridge: The Boydell Press, 2012.

⁸⁰le xxiiij^{te} iour de Octobre... Nicholo de Loderyn ad vendu a John Boyles querens; TNA, E101/128/30 return 1; *Views of hosts*, f. 109... le xxj iour de Novembre ...Nicholo de Loderyn ad vendu le mesme iour a Robert Bryge querens (po aty, f. 112). Ky Nikolla del edhe në galetë që mbërrijnë në Londër në vitet 1435-1436, 1437-1438, 1438. TNA E122/76/34, E122/77/3, E122/73/10.

⁸¹Këtë person Bradley e transkripton si "Domenico de Bayon [ne]", që i shet të njëjtit John Boyle stafidhe (querens), njëlloj sikur Nikolla nga Lodrini. Shumë tregues na bëjnë të mendojmë se autorja e ka identifikuar gabim si nga Bajona, (Spanja). Së pari ai del menjëherë mbas Nikolla Lodrini, dhe për më tepër shet të njëjtin mall si bashkëpatrioti i tij. Së dyti, në krejt mesin e ekuipazhit nuk del asnjë spanjoll, por dalin pothuajse gjysma shqiptarë, dhe pjesa tjetër grekë e dalmatë.

Shkodra⁸², Kozmai nga Durrësi⁸³, Antoni nga Drishti⁸⁴, Pali nga Barbullushi⁸⁵, Andrea nga Lezha⁸⁶, Pali nga Lezha⁸⁷, Gjoni nga Lezha⁸⁸,

Edhe leximi i emrit në dokumentin origjinal del Boyon, apo Bayon. *TNA*, E101/128/30 return 1; *Views of hosts*, f. 109. Të njëjtën dyshim e shpreh edhe në notat biografike, “or perhaps from Baiona in Spain, or from Bayonne” (Francë). Bradley, *po aty*, f. 273. Dimë se në galerën e Petrus Surans që hyn në Southampton nga Flandra, më 26 shtator 1481, del Georgeo de Boyano, bashkë me shkodranë të tjerë si Lazaro de Squytery, Marco Stroce, Laurencio Barduche, Paulo de Seynt George, Georgeo Squytero, Beasio de Squytery dhe Primo Suma. *PBS*, Book G, *Liber Alienigenus*, 1480- 1481, fl 22-23v. Një Jeronim da Boyano del në Londër, më 12 maj 1444, në listën e bujtinës së William Chervyle në mesin e ekupiazhit të galerës së Alessandro Duodos, bashkë me Todoro da Mosake, Andrea da Jane, Marino d’Antivori, Marino da Zagabria, Polo da Madrose, Andrea da Montebello, Domenico d’Antivori. *TNA*, E101/128/30 return 4.

⁸² *Views of hosts*, f. 109. le xxv^{te} iour d Octobre... Basile de Scotery ad vendu le mesme iour a John Leet querens.

⁸³ *Po aty*, f. 110. le xxvj^{me} iour d’Octobre ... Cosma de Doras ad vendu...a Thomas Hawkyns peper

⁸⁴ *Po aty*, f. 110. le xxvij^{me} iour d’Octobre lan suisdit Antony de Dryvesto ad vendu a Esmond Keruyle sugre

⁸⁵ *Po aty*, f. 110. Poule de Barbalovsy ad vendu le mesme iour au dit Robert querens.

⁸⁶ *Po aty*, f. 111. Andrew de Lesch ad vendu le mesme iour a William Rose sugre ... Andria de Lesso ad vendu le mesme iour a Nicholas Wifold ginger vert; Andrea de Lesse ad vendu le mesme ioura John Sporle peper; (*po aty*, f. 112). *membrane 1B*: le xx^{me} iour de Decembre... Andria Leschle mesme iour a John Trille peper (*po aty*, f. 113-114). Po ky Andrea nga Lezha, kishte mallra edhe në gale të e vitit 1438-1439; *TNA*, E 122/73/10.

⁸⁷ *Views of hosts*, f. 112.... Poule de Lesch ad vendu le mesme iour a Esmond Kerule querens; (*po aty*, f. 114.) *membrane 1B*, Ile xij^{me} iour de Decembre lan suisdit Poule de Lesch ad vendu a Thomas Muschamp ginger vert. Del edhe në një nga gale të veneciane që mbërrijnë në Londër në 1437-1438; *TNA*, E 122/77/3.

⁸⁸ *Views of hosts*, f. 112. John de Leso ad vendu le dit iour a dit Esmond querens, (*po aty*, f. 114). *membrane 1B*: le vij^{me} iour de Janever ... John de Lesse ad vendu le mesme iour a John Matsale ginger vert; (*po aty*, f. 115) le iij^{ce} iour de Feverere .. John de Lesse ad vendu le dit iour a Thomas Cayle triacle. Ky Gjon nga Lezha kishte qenë i pranishëm edhe në gale të e vitit 1435-1436 dhe të viti 1438 që mbërrijnë në Londër; *TNA*, E 122/76/34, E 122/73/10. Po ashtu një Gjon nga Lezha del edhe në ekuipazhin e një prej galeve veneciane që ndalon në Southampton më 1440. *LPBS*, 1439-40, fl. 77.

Gjergji nga Malësia, ose nga Mali i Shoshit⁸⁹ dhe Gjoni nga Drishti⁹⁰. Përsa i përket blerjeve që detarët shqiptarë bëjnë në Londër gjatë kësaj periudhe, del vetëm Andrea nga Lezha⁹¹ që kryen blerje.

Në se e marrim si të mirëqenë faktin që në vitin 1473, kur shkruan testamentin e tij në faqet boshe të dorëshkrimit të Mikelit nga Rodi, ka qenë në moshë të thyer, del se Gjon Drishtjani i cili del në regjistrin e Southamptonit më 1439, është Gjon Drishtjani i testamentit të vitit 1473, çka është plotësisht e mundur, që të ketë pasur një shërbim prej 34 vitesh në këtë kohë. Vetë Mikeli nga Rodi, pohon se kishte shërbyer për 42 vjet në galetë e Flandrës. Kjo mund të shpjegojë edhe faktin që dorëshkrimi gjendej në zotërimin e Gjonit më 1473, mbasi është krejt e mundshme që të dy detarët të kenë udhëtuar së bashku në flotën e vitit 1443, kur vdes edhe Mikeli. Duket se Mikeli ia ka dorëzuar Gjonit dorëshkrimin, përpara se të vdiste.

Fakti që Gjoni në këtë kohë ishte i ri, por jo i pa përvojë në det, mund ta shpjegojë këtë. Është e kuptueshme që një njeri në prag të vdekjes nuk do të lërë porositë e fundit dikujt që është edhe ai në moshë të thyer, por dikujt që është i ri dhe ka mundësi të kryejë porositë. Është për t'u nënvizuar edhe fakti që Gjoni e harton testamentin e tij, pikërisht në vendlindjen e Mikelit. A ndodhej atje qëllimisht për të kryer ndonjë amanet që Mikeli mund t'i ketë lënë për familjarët e tij? Kjo as nuk mund të përjashtohet, por as nuk mund të pohohet. Gjithsesi, mund të shtrohet si hipotezë.

Por kufijtë kohorë në të cilët dëshmohet prania e Gjon Drishtjanit në Angli bien ndërmjet vitit 1439-40 dhe 1481, pra 41 apo 42 vjet në shërbim. Fakti që e ka shkruar testamentin e tij më 1473, nuk është

⁸⁹ *Views of hosts*, f. 113. George Malesaws ad vendu le mesme iour a John Glouceter peper.

⁹⁰ *Po aty*, f. 114. John de Drivasto ad vendu le dit iour a dit Esmond querens; le dit iour a John Weldon querens; (*po aty*, f. 115)... John de Drivasto ad vendu le xj^{me} iour de Fever e lan suisdit a John Akris triacle. Bradley, *vep.cit.*, f. 305, në notën biografike edhe pse në dokumenta del krejt qartë si Giovanni da Drivasto, pa asnjë dyshim mendon se është nga Trieste. Si duket nuk e merr parasysh faktin se del gjithnjë në mesin e bashkëpatriotëve të tjerë nga zona e Shkodrës dhe Lezhës. Ky Gjon nga Drishti del edhe në galetë që mbërrijnë në Londër më 1445-1446 (*TNA*, E122/203/3) dhe në 1456-1457 (*TNA*, E 122/203/4).

⁹¹ *Views of hosts* f. 116. Andria de Lessh achata le iij^{ce} iour de Janever de John Jurdan xij streites ... achata de John Lenge le xxij iour de Janever xvj streites... de luy le mesme iour xij kerseys...de John Boton ij worstedes.

kurrsesi provë se ka vdekur pikërisht në atë kohë. Aq më tepër që leximi paleografik tregon se nuk është i një noteri, por i vetë Gjonit⁹². Kështu, Gjoni nga Drishti, del në galenë e Alowisus George, që mbërrin në Southampton nga Mesdheu në vitin 1481 dhe të ketë shitur 1 shportë me sapun. Bashkë me të dalin edhe Johanne de Squytery⁹³ dhe Johanne de Ludryn, që edhe këta shesin po ashtu sapun⁹⁴. Edhe kur e njëjta gale hyn në Southampton, më 26 shtator 1481, tashmë kur po ktheheshin nga Flandra shet 30 pashë cohë të linjta flamenge. Përveç Gjonit kryejnë shitje mallrash flamenge edhe tre drishtjanë të tjerë dhe një shkodran: Demit Drivastini, Nikollë Drivastini, Pero nga Drishti, Pali nga Shkodra⁹⁵ dhe Dimitri nga Liqeni (i Shkodrës).⁹⁶

Mbas rënies së Shkodrës dhe Drishtit nën sundimin osman, shqiptarët vazhdojnë të jenë të pranishëm në rrugën detare të Flandrës, deri sa kriza e kësaj tregtie merr përmasa të tilla, saqë edhe Venediku, shteti i fundit italian në këtë linjë tregtare më 1509 vendos pezullimin e saj për më se një dekadë, dhe në vitin 1532 mbylljen përfundimtare⁹⁷. Kështu vetëm në galenë e Bernard Bondymer⁹⁸ mbërritur në Londër më 14 qershor 1481 dhe që largohet nga porti i Londrës më 18 shtator 1481 dalin, Alesio Summa, Beasio de Lago, Francis de Meseo, George de Camsa, George de Scutery, John de Luderyn, John Camsa, John de Asdryna, John Masarachio, John de Squetery, Luke de Squetery, Nicholas Maserachio, Nicholas de Squetery, Nadale de Lago, Nicholas Somma, Novello de Lago, Paul Lago, Pero de Squetery, Primo de Squetery, Stephen de Lago, Travaso de Luderyn, Luke Kamsa, Andrea de Squetery, George

⁹² Simbas Rossi, "Introduction to the Manuscript", f. xxxi, autori i këtyre dy faqeve mund të konsiderohet një person që "had not had many opportunities to develop adequate confidence in writing".

⁹³ *PBS*, II, 1477-1481. Book G. Liber Alienigenus, 1480- 1481, fl. 18v-19.

⁹⁴ *Po aty*, fl. 20-20v.

⁹⁵ *Po aty*, fl. 24-24v.

⁹⁶ *Po aty*, fl. 18v2.

⁹⁷ Më 22 maj 1532, galerat e Flandrës lanë portin e Londrës për të mos u kthyer më kurrë. Brown, *CSP, Venice*, I, f. lxx.

⁹⁸ Flota e vitit 1480 e përbërë nga tri galera hyri në Southampton më 12 shkurt 1481. Mbasi qëndruan aty për rreth tre muaj, galera e Bondymer-it u nis për në Londër, ku mbërrin më 14 qershor dhe largohet më 18 shtator, ndërsa dy të tjerat për Flandër. *TNA*, E 122/194/25, [m.1]; *The Overseas Trade of London. Exchequer Customs Accounts 1480-1*, Edited by H. S. Cobb, London: London Record Society, 1990, f. xliii; *PBS*, II, 1477-1481, f. xxix.

de Lago. Mallrat që shesin këta shqiptarë janë kryesisht qilima, vaj, qelqurina, sapun, mëndafsh, rruaza korali, hurma të thata, erëza, gota për pije, ngjyrosës pëlhurash, unaza me gurë. Mallrat që blejnë janë pëlhura, lëkura të ngjyrosura, enë kallaji⁹⁹.

Siç shihet, prania e shqiptarëve në galerat veneciane të Flandrës mbas vitit 1479 bëhet akoma edhe më e rëndësishme. Kjo rritje e pranisë së shqiptarëve është me interes jo vetëm për faktin se dëshmon që një pjesë e mirë e atyre banorëve të pellgut të Shkodrës e Lezhës të cilët emigruan për në Venedik mbas përfundimit të Luftës Veneto-Otomane të viteve 1463-1479, gjetën një mundësi punësimi, por edhe për të vlerësuar tërthorazi peshën që këta shqiptarë të punësuar në galetë e Venedikut zunë në mesin e viktimave të një beteje detare ndërmjet piratëve dhe galeve të Flandrës të ndodhur më 1485, në brigjet portugeze.

Tmerri i galerave venedikase ishte bërë një korsar francez, i quajtur Coullon, apo Colombo. Më 1469, ky Coullon kapi dy galera venedikase në brigjet e Flandrës dhe i plaçkiti¹⁰⁰. Një vit më vonë Senati i informuar për praninë e tij në zonën e La Manshit, urdhëron galerat e Flandrës që të qëndrojnë në Southampton, deri sa të mbërrinin përforcimet e dy galerave të tjera¹⁰¹.

Por fatkeqësia më e madhe që do t'u binte venedikasve gjatë gjithë historisë së kësaj linje tregtare do t'u vinte nga dy Kolombë të tjerë. Njëri, i quajtur Kolombo i ri, ose Giorgi Bissipat, ndërsa tjetri ishte bashkëpunëtor i ngushtë dhe nxënës i Bissipatit, dhe ishte pikërisht i famshmi Kristofor Kolombi. Në afërsi të Lisbonës më 21 gusht 1485, galetë e Flandrës kur po lundronin drejt Anglisë e Flandrës, nën komandën e Bortolomeo Minio, u sulmuan nga korsari Bissipat dhe Kristofor Kolombi. Anijet pirate ishin gjashtë dhe mbanin flamur francez. Mbas një beteje që zgjati 20 orë, 130 anëtarë të ekuipazhit të anijeve venedikase u vranë dhe 300 u plagosën. Trupat e të varrëve u hodhën në Oqean¹⁰².

⁹⁹ S. Cobb, *Exchequer Customs Accounts ...*, f. 159-162.

¹⁰⁰ Henry Vignaud, *Études critiques sur la vie de Colomb avant ses découvertes*, Paris: Welter, 1905, f. 141.

¹⁰¹ 17 maj 1470. *ASV, Senato Mar.* v. ix. Brown, *CSP, Venice*, I, f. 125.

¹⁰² Lajmi i kësaj tragjedie mbërriti në Venecia më 18 shtator 1485, dhe Sanudo pohon se fillimisht numri i të varrëve u mendua të ishte treqind. Marin Sanuto, *MS. Lives of the Doges*, vol. ii, f. 254; *CSP, Venice*, I, nr. 499.

Se sa nga të vrarët dhe të plagosurit ishin shqiptarë nuk dihet, por duke u nisur nga fakti se çdo galerë venedikase e linjës së Flandrës në shek. XV, kishte një numër të konsiderueshëm shqiptarësh në ekuipazhin e saj, dhe siç e pamë pikërisht në këto vite numri i tyre u bë edhe më i madh, mund të kemi një ide të përafërt për fatin e atyre shqiptarëve që janë ndodhur në bordin e atyre galerave, që kurrë nuk mbërritën në destinacion. Organizimi i galeve të tjera të Flandrës u pezullua nga Senati për vite të tëra dhe dëmi i shkaktuar në këtë rast u vlerësua nga Senati plot 200 mijë dukatë¹⁰³. Ky akt i rëndë, u justifikua nga piratët si kryqëzatë, ngaqë pak kohë më parë Papa Siksti IV (1471-1484) e kishte shkishëruar shtetin venedikas¹⁰⁴. Njëra nga galerat u dogj gjatë sulmit, ndërsa tri të tjerat, mbetën për njëfarë kohe të dëmtuara në Lisbonë, derisa Senati Venedikas vendosi që t'i faleshin Mbretit portugez Zhoao II, në shenjë mirënjohje për ndihmën që u kishte dhënë detarëve të mbijetuar. Në këtë periudhë të vështirë as në port venedikasit nuk ndjeheshin më të sigurt¹⁰⁵.

Pjesmarrja e Kristofor Kolombit në një tragjedi të tillë, përkundër shumë fakteve që e dëshmojnë, është vënë në dyshim nga autorë të

¹⁰³ *CSP, Venice*, I, nr. 510.

¹⁰⁴ Interdiksi papal u publikua në qershor të vitit 1482, për shkak të mosbindjes së Venedikut për të braktisur rrethimin e Ferrarës. Senatorët venedikas të ndërgjegjshëm për dëmet që mund t'u sillte një masë e tillë, caktuan një komision të posaçëm prej pesë vetash, të cilit iu caktua si mision që të apelonte këtë vendim në Vatikan. Në përbërjen e këtij komisioni, u caktua edhe ipeshkvi i Krugës, Piero da Monte. David Sanderson Chambers, Jennifer Fletcher, Brian Pullan, *Venice: A Documentary History, 1450-1630*, University of Toronto Press, 2001, f. 219-220; Ludwig von Pastor, *The History of the Popes from the Close of the Middle Ages: Drawn from the Secret Archives of the Vatican and other Original Sources*, Vol. IV, London: Kegan Paul, 1900, f. 372-373, pohon se armiqësia ndërmjet Papatit dhe Venedikut për shkak të Ferrarës shkoi deri aty, saqë venedikasit kërcënuan se nëse Papa shpallte kryqëzatën kundër Venecias, atëherë kjo e fundit do të thirrte në ndihmë të gjitha fuqitë e krishtera që ishin aleatë të saj, madje në se do të ishte nevoja do të thërrisnin edhe turqit në ndihmë të tyre. Ky autor mendon se informacioni që jep Sanudo, rreth nisjes së Melchior Trevisan për në Stamboll, ka të bëjë me këtë kërcënim.

¹⁰⁵ Në tetor 1495, në kohën kur galera kryesore e flotës veneciane ndodhej në Southampton, dy anije franceze, hynë befasisht dhe morën me vete galerën venedikase bashkë me kapitenin Piero Bragadin, dhe konsullin Almorò Gritti, dhe i çuan në Francë për t'i liruar kundrejt shpërblimit. *CSP. Venice*, I, nr. 646, 658-9, 673.

ndryshëm, dhe kjo është e kuptueshme po të kemi parasysh rëndësinë e figurës së tij në histori mbas vitit 1492¹⁰⁶. Por, ai që na intereson këtu është Kolombi i ri ose Giorgi Bissipat. Ky dihet se në fakt nuk ka pasur lidhje gjaku e familjare as me Kolombin e vjetër (Guillaume Caseneuve), dhe as me Kristofor Kolombin¹⁰⁷. Dokumentet e përmendin si Giorgi Greco, apo Giorgi Bissipat, një detar me origjinë nga Greqia që lundronte nën lejen dhe flamurin e Mbretërisë Franceze. I biri i Kristofor Kolombit, Fernando, e shpjegon mbërritjen e të atit në Spanjë, duke pohuar se ka ardhur me këtë Colombo të riun, nën udhëheqjen e të cilit kishte lundruar për shumë vite¹⁰⁸.

Pa hyrë në diskutimin e përkatësisë etnike të Kolombit të riut, mendojmë se është me interes të thuhet se mbiemri i tij, shpjegohet shumë më lehtë me patronimin Buashpata, se sa me atë që pretendon një autor grek, gjoja *Georgios Palaiologos Dishypatos*, ku pjesa e fundit e emrit paraqitet sikur ka kuptimin «dy herë konsull», një titull që ndeshet në Bizant ndërmjet shek. VIII e XI¹⁰⁹. Nuk përjashtohet mundësia që të bëhet fjalë për një detar Buashpatas nga Koroni¹¹⁰. Kjo mund të

¹⁰⁶ Një kritikë e re rreth burimeve dhe jetëshkrimit të Kristofor Kolombit është: Miles H. Davidson, *Columbus Then and Now: A Life Reexamined*, University of Oklahoma Press, 1997, f. 30-33.

¹⁰⁷ Simbas Davidson, *Columbus Then and Now*, f.13. "there is absolutely no proof for a claim for a blood relationship with either corsair".

¹⁰⁸ Hernando Colón, *Historia del Almirante*, Edición de Luis Arranz, Madrid: Historia 16, 1984, f. 58-61.

¹⁰⁹ Georgios Palaiologos Dishypatos « ὁ δισύπατος ». Seraphim G. Canoutas, *Christopher Columbus, a Greek Nobleman. A Disquisition Concerning the Origin and Early Life of the Great Discoverer and a Refutation of the Charges against Him which have appeared in certain recent Publications*, New York: The Author, 1943. Simbas hamendësimeve të këtij autori, ai është larguar nga Konstandinopja për në Francë menjëherë mbas vitit 1453, ku u bë korsar me emrin Georges le Grec, dhe mori emrin "Colon" si emër lufte. H. Vignaud, *Études critiques sur la vie de Colomb avant ses découvertes ...*, merret me Georges de Bissipat (f. 165-189) dhe mendon se dy Kolombot (Guillaume de Casenove e Georges de Bissipat) nuk kanë asnjë lloj lidhje origjine. Shih edhe: Christine Isom-Verhaaren, *Allies with the Infidel: The Ottoman and French Alliance in the Sixteenth Century*, London, New York: I.B.Tauris, 2013, f. 67-72, e cila gjen një kushëri të Bissipatit, i bërë musliman me emrin Hysen edhe ky detar, por në flotën osmane.

¹¹⁰ H. Vignaud, *Études critiques sur la vie de Colomb avant ses découvertes ...*, f. 139, vëren se edhe emri i Guillaume de Casenove, shkruhet në mjaft raste si Koron. Ndërsa për Bissipatin, thotë: «ce personnage... s'appelait de son vrai

shpjegonte edhe ngatërrimin dhe hutinë që shkakton fakti që një «grek» të quhet Kolombo apo Coullon. Po ashtu është e vështirë të shpjegohet se si një Paleolog të mos përdorë patronimin e tij, por të përdorë si emër mburrjeje Kolomb. Ajo që dihet me siguri është se Koroni ka qenë një port i rëndësishëm në skajin jugperëndimor të Moresë, dhe që në More, Buashpatat dalin si një nga familjet më të rëndësishme gjatë gjithë shek. XV¹¹¹.

S u m m a r y

ABOUT THE PRESENCE OF ALBANIAN SEAMEN IN ENGLAND DURING THE MIDDLE AGES

The evidences presented in this paper are part of a broader study about the presence of the Albanians in England during the Middle Ages. Our goal here is that in general terms to give an overview about the presence of Albanians in England in the Middle Ages, and at the same time to serve as a modest contribution to correctly identify many persons, who in the works of some scholars, are presented without proper argumentation as Italians, Dalmatians, Slavs, Greeks and even as Spanish, Portuguese, French, or as unidentified.

The evidences about the presence and the role of the Albanians in northern European countries, especially the Low Countries and England in the 14th and 15th centuries, though few in number, are important because they shed light on little known or unknown aspects of the history of the Albanians in this period.

nomme Georges de Byssipat, mais il est désigné dans plusieurs documents simplement sous le nom de Georges-le Grec et lui-même signait G. de Byssipat, dit le grec». Edhe dokumenti i natyralizimit të tij si shtetas francez, i vitit 1477, nuk përmend patronimin Paleolog, por thjesht Byssipat: «Georges de Bicepat, dit le Grec, chevalier, natif du pais de Grèce». (*po aty*, f. 170, 174).

¹¹¹*Cronaca dei Tocco di Cefalonia. Di Anonimo*. Prolegomeni, testo critico e traduzione, a cura di Giuseppe Schirò, Roma, Accademia nazionale dei Lincei, 1975. Përkthyer pjesërisht shqip nga Koço Bozhori, Filip Lico, *Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë*, Akademia e Shkencave e RPSH, Tiranë, 1975, f. 251-315; Rreth pranisë së shqiptarëve në zonën e Koronit në shekullin e XV shih edhe: Alain Ducellier, “Les Albanais dans les colonies vénitienes au XVe siècle”, *Studi Veneziani*, 10, 1968, f. 49-50, 52-53, 56, 62.

The way and the means of arrival of these Albanians in northern Europe were nautical, on board of Italian merchant vessels, mostly Venetian, in their journeys of the Flanders fleet. The Flanders galleys constituted the most remarkable trading fleet of the Venetian Republic, because their journey was the most dangerous and difficult, in the geography of the maritime history of the medieval Venice. Their itinerary involved an intermediate trade with the principal ports of Sicily, Balearic Islands, Southern Spain and Portugal.

The employment of the Albanians as oarsmen in the Flanders galleys can be traced even earlier than the inclusion of the Albanian coastal cities in the Venetian territorial extension. Although being part of a sea-going proletariat recruited from the eastern shores of the Adriatic, many Albanian oarsmen and sailors acted also as small scale entrepreneurs, carrying with them in these long voyages a limited number of wares and products, which they traded in the port-cities of Northern Europe, namely, London, Southampton and Bruges. Most part of the Albanians employed in these galleys, came from the Shkodrabasin (Scutari, Drivasto, Dagno and the villages on the shores of Shkodra Lake), Lezha (Alessio) and Durrazzo. The Albanians like the other sailors, shared not only the profits of this trade, but also the inherent dangers and difficulties that faced these galleys.

